



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.32/2022

GJYKATA KOMERCIALE – DHOMA E SHKALLËS SË DYTË, e përbërë nga gjyqtari individual Faton Bajrami, në çështjen përbarimore të kreditorit “M...” sh.p.k, me seli në Prishtinë, ndaj debitorit Kompania e Sigurimeve “E...” Sh.A, me seli ne Prishtinë, me bazë përbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.1365/19, të datës 22.07.2019, me datë 29.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e kreditorit “M...” sh.p.k, me seli në Prishtinë, ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.1365/19, të datës 22.07.2019, dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.1365/19, të datës 22.07.2019, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit Kompania e Sigurimeve “E...” Sh.A, me seli ne Prishtinë dhe e ka shfuqizuar urdhrin përbarimor, P.nr.1016/19 te datës 14.06.2019, të lëshuar nga zyra përbarimore e përbaruesit privat Destan Bujupaj, në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, ne kuptim te nenit 71 par.1 te LPP, me propozim që gjykata e shkalles se dytë, të aprovojë si të bazuar ankesën e kreditorit dhe aktvendimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë ta anuloj, prapësimin e debitorit ta refuzoj si te pabazuar ndërsa urdhri për përbarim te mbetet ne fuqi.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

Ankesa është e themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania e Sigurimeve “M...” Shpk me seli në Prishtinë, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit Kompania e Sigurimeve “E...” Sh.a me seli ne Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturave me numër 1-1213, 1-1228, 1-635, 1-357, 1-294, 1-238, 1-283, 1-32, 1-103, 1-1602, 1-1576, 1-1545, 1-1495, 1-1430, 1-1366, 1-1323, 1-806, 1-791, 1-658, 1-635, 1-267, 1-127, 1-86, 1-11, 1-1754, 1-1742, 1-1710, 1-1450, 1-1441, 1-1357, 1-1223, 1-1145, 1-936, 1-568, 1-539, 1-174, 1-81, 1-296, 1-14, te gjitha këto në vlerë prej 5,504.80 euro. Përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin me urdhrin P.nr.1016/19 dt.14.06.2019, ndaj të cilit urdhër debitorit ka ushtruar prapësim ndërsa kreditori ka ushtruar përgjigje ne prapësim. Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimi dhe përgjigjes në prapësim ka vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e shkalles se dytë, vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta pranojë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje procedurale dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183, paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje te dispozitave te procedurës përmbartimore ne kuptim te nenit 29 LPP dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183, paragrafi 1 të LPK-së, kur ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit ndërsa ka shfuqizuar urdhrin për përmbartim. Gjykata, në rastin konkret nuk i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë te gjitha faturat e prezantuara e te bashkëngjitura propozimit për përmbartim, pasi një pjesë e tyre janë te nënshkruara dhe vulosura konform nenit 37 te LPP. Andaj me qellim te vlerësimit dhe verifikimit te gjitha faturave si dhe analizimit te pretendimeve te palëve ne procedurë, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkalles se parë duhet ta këtë parasysh nenin 73 par.1 të LPP-së, ku mes tjerash përcakton se: *“Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përjashtimisht Gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimi. Gjykata do të njoftojë të gjitha palët për dëgjimin publik...”*. Andaj, nga të cekurat më lartë, aktvendimi i ankimuar duhet të anulohet dhe çështja të kthehet në procedim të serishëm në gjykatën e shkallës së parë.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë duhet të këtë parasysh te gjeturat e gjykatës se shkalles se dytë, të vlerëson në mënyrë të drejtë dokumentin e besueshëm, nëse faturat sipas

dispozitive të LPP-së, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente te besueshme, ashtu që të shqyrtoj prapësimin duke caktuar seancë dëgjimore në kuptim të dispozitive të lartcekura, të ftohen palët ndërgjyqëse, që të njëjtat të deklarohen rreth pretendimeve të tyre, duke ofruar prova materiale lidhur me këtë e më pastaj varësisht nga të gjeturat edhe të vendos konform dispozitive ligjore duke marrë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE – DHOMA E SHKALLËS SË DYTË
Kom.Dh.Shk.II.nr.32/2022, me datë 29.09.2022

Gjyqtari,
Faton Bajrami